



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 70

Datë 20 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 42/2014 datë 24.4.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	2611
Ligj nr. 43/2014 datë 24.4.2014	Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	2613
Ligj nr. 44/2014 datë 24.4.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funsioneve publike”, të ndryshuar.....	2614
Ligj nr. 46/2014 datë 24.4.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit të ndërtimit të rrugës Tiranë - Elbasan - Qukës - Qafë e Plloçës.....	2615
Ligj nr. 48/2014 datë 24.4.2014	Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare.....	2621
Udhëzim i MF nr. 6/4, datë 16.5.2014	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.....	2625
Vendim i KZHR nr. 4, datë 9.5.2014	Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, thirrja e dytë	2625
Vendim i KZHR nr. 5, datë 9.5.2014	Për shpalljen e thirrjes për ndarjen e fondit për arsimin, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.....	2627

LIGJ
Nr. 42/2014

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Për qëllime të neneve 36-36/7 të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) Dy persona konsiderohen të jenë palë të lidhura, kur:
 - i) një person merr pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e personit tjetër; ose
 - ii) i njëjti/të njëjtët person/persona marrin pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e të dy personave.
- b) Një person merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një personi tjetër, kur:
 - i) ai person zotëron, direkt ose indirekt, 50 për qind ose më shumë të kapitalit aksionar të personit tjetër; ose
 - ii) efektivisht kontrollon vendimet e biznesit të këtij personi tjetër.
- c) “Palë të pavarura” janë palët që nuk janë palë të lidhura.
 - ç) “Transaksion i kontrolluar” është:
 - i) çdo transaksion midis palëve të lidhura, kur:
 - njëra nga palët në transaksion është rezidente dhe tjetra jorezidente;
 - njëra nga palët në transaksion është një jorezident që ka një seli të përhershme në Shqipëri, së cilës i atribuohet transaksioni, dhe pala tjetër është një person tjetër jorezident;
 - njëra palë në transaksion është një rezident dhe pala tjetër është një rezident që ka një seli të përhershme jashtë Shqipërisë, së cilës i atribuohet transaksioni;
 - ii) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një jorezidenti dhe një selie të përhershme në Shqipëri të atij jorezidenti;
 - iii) çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet një rezidenti dhe selisë së përhershme të tij jashtë Shqipërisë;
 - iv) çdo transaksion ndërmjet një rezidenti apo një jorezidenti që ka një seli të përhershme në Shqipëri, së

cilës i atribuohet transaksioni, me një rezident të një juridiksioni të listuar me udhëzim të ministrit të Financave.

d) “Transaksion i pakontrolluar” është çdo transaksion ndërmjet palëve të pavarura.

dh) Termi “transaksion” përfshin një ujdj, mirëkuptim, marrëveshje apo praktikë direkte ose indirekte mes palëve, e detyrueshme ose jo ligjërisht apo me synimin që të jetë ligjërisht e detyrueshme, dhe përfshin çdo marrëdhënie biznesi ndërmjet personave të lidhur.

e) Kushtet e një transaksioni përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, treguesit financiarë të matur në aplikimin e metodës së duhur të transferimit të çmimit, p.sh., çmimi i transaksionit, marzhi bruto apo fitimi neto i përfituar nga një prej palëve në transaksion, ose ndarja e fitimit midis palëve në transaksion.

ë) “Marrëveshje çmimi në avancë” është një marrëveshje procedurale ndërmjet një apo më shumë tatimpaguesve dhe një apo më shumë administratave tatimore, me qëllim zgjidhjen në avancë të mosmarrëveshjeve të mundshme të transferimit të çmimit, duke përcaktuar, para kryerjes së transaksioneve të kontrolluara, një grup kriteresh të përshtatshme për përcaktimin e përputhshmërisë së këtyre transaksioneve me parimin e tregut.

Neni 2

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Transferimi i çmimit

1. Nëse një tatimpagues që është subjekt i tatimfitimit merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara, ai duhet të përcaktojë fitimin e tatueshëm në një mënyrë që është në përputhje me parimin e tregut.

2. Fitimet e tatueshme të një tatimpaguesi që merr pjesë në një apo më shumë transaksione të kontrolluara do të konsiderohen në përputhje me parimin e tregut, nëse kushtet e këtyre transaksioneve nuk janë të ndryshme nga kushtet që do të ishin aplikuar ndërmjet palëve të pavarura në transaksione të krahasueshme, të kryera në rrethana të krahasueshme.

3. Kur kushtet e vendosura apo të diktuar në një a më shumë transaksione të kontrolluara, të kryera nga një tatimpagues, nuk janë në përputhje me parimin e tregut, atëherë fitimet e tatueshme të atij tatimpaguesi mund të rriten në atë masë që të jenë në përputhje me parimin e tregut.

4. Përcaktimi nëse kushtet e një transaksioni të kontrolluar janë në përputhje me parimin e tregut dhe masa e çdo rregullimi, sipas pikës 3 të këtij neni, do të bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 36 të këtij ligji.”

Neni 3

Pas nenit 36 shtohen nenet 36/1, 36/2, 36/3, 36/4, 36/5, 36/6 dhe 36/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Krahasueshmëria

1. Një transaksion i pakontrolluar është i krahasueshëm me një transaksion të kontrolluar, për qëllime të këtij kapitulli:

a) kur nuk ka diferenca të rëndësishme midis tyre që mund të ndikojnë materialisht treguesit financiarë që po kontrollohen, sipas metodës së përshtatshme të transferimit të çmimit; ose

b) kur ekzistojnë të tilla diferenca, një rregullim i arsyeshëm i bëhet treguesit financiar përkatës të transaksionit të pakontrolluar, me qëllim eliminimin e efekteve të këtyre diferencave në krahasim.

2. Për të përcaktuar nëse dy apo më shumë transaksione janë të krahasueshme, do të merren në konsideratë, në masën që ata janë ekonomikisht të përshtatshëm për faktet dhe rrethanat e transaksionit, këta faktorë:

a) karakteristikat e pronës, mallit apo shërbimeve të transferuara;

b) funksionet e marra përsipër nga secila palë në lidhje me transaksionet, duke marrë në konsideratë asetet e përdorura dhe risqet e marra;

c) kushtet kontraktuale të transaksioneve;

ç) rrethanat ekonomike në të cilat ndodhin transaksionet; dhe

d) strategjitë e biznesit të ndjekura nga palët në lidhje me transaksionet.

Neni 36/2

Metodat e transferimit të çmimit

1. Përputhshmëria me parimin e tregut e një transaksioni të kontrolluar do të përcaktohet duke aplikuar metodën më të përshtatshme të transferimit të çmimit, sipas rrethanave të rastit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit të Financave. Përveç sa parashikohet në pikën 2, metoda më e përshtatshme e transferimit të çmimit do të zgjidhet midis metodave që vijojnë:

a) metoda e çmimit të pakontrolluar të krahasueshëm, e cila konsiston në krahasimin e çmimit të vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të kontrolluar me çmimin e vendosur për mallra apo shërbime të transferuara në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

b) metoda e çmimit të rishitjes, e cila konsiston në krahasimin e marzhit të rishitjes, që një blerës mallrash në një transaksion të kontrolluar fiton nga rishitja e asaj prone në një transaksion të pakontrolluar, me marzhin e rishitjes që fitohet në transaksione shitblerjesh të pakontrolluara të krahasueshme;

c) metoda kosto plus, e cila konsiston në krahasimin e rritjes (marzhit të fitimit) mbi kostot direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave e shërbimeve në një transaksion të kontrolluar me rritjen, marzhin e fitimit të këtyre kostove direkte dhe indirekte në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm;

ç) metoda e marzhit neto të transaksionit, e cila konsiston në krahasimin e marzhit neto të fitimit ndaj një baze të përshtatshme, p.sh., kostot, shitjet, asetet, që një palë arrin në një transaksion të kontrolluar, me marzhin neto të fitimit ndaj së njëjtës baze të arritur në transaksione të pakontrolluara të krahasueshme;

d) metoda e ndarjes së fitimit të transaksionit, sipas së cilës çdo personi të lidhur që merr pjesë në një transaksion të kontrolluar i alokohet pjesa e fitimit të përbashkët/humbjes që rrjedh nga ky transaksion që një person i pavarur do të fitonte nga pjesëmarrja në një transaksion të pakontrolluar të krahasueshëm.

2. Tatimpaguesi mund të aplikojë një metodë të transferimit të çmimit të ndryshme nga metodat e mësipërme, kur ai provon se asnjë nga metodat e miratuara nuk mund të përdoret në mënyrë të arsyeshme për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e kontrolluara dhe kjo metodë tjetër jep një rezultat në përputhje me parimin e tregut. Tatimpaguesi që përdor një metodë të ndryshme nga metodat e miratuara, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, do të ketë barrën e provës për të demonstruar se kërkesat e këtij kreu janë përmbushur.

3. Për të përcaktuar përputhshmërinë me parimin e tregut për një transaksion të kontrolluar, nuk kërkohet të aplikohet më shumë se një metodë.

4. Kur një tatimpagues ka përdorur një metodë të transferimit të çmimit për të vendosur shpërblimin e transaksioneve të tij të kontrolluara dhe kjo metodë e transferimit të çmimit është në përputhje me dispozitat e këtij neni, atëherë kontrolli i administratës tatimore mbi faktin nëse kushtet e transaksioneve të kontrolluara të tatimpaguesit janë në përputhje me parimin e tregut, bazohet në metodën e transferimit të çmimit të aplikuar nga tatimpaguesi.

Neni 36/3

Vlerësimi i transaksioneve të kontrolluara të kombinuara

Nëse një tatimpagues kryen, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, dy ose më shumë transaksione të kontrolluara, që janë ekonomikisht të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin ose që përbëjnë një vazhdimësi/kombinim të caktuar, në mënyrë të tillë që ato nuk mund të analizohen veçmas në mënyrë të besueshme, këto transaksione mund të kombinohen:

a) për të kryer analizën e krahasueshmërisë, të përcaktuar në nenin 36/1; dhe

b) për të aplikuar metodat e transferimit të çmimit, të përcaktuara në nenin 36/2.

Neni 36/4

Diapazoni i treguesve të tregut

1. Diapazon tregu është një grup treguesish financiarë përkatës, p.sh., çmimet, marzhet apo pjesët e fitimit, të nxjerra nga aplikimi i metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit për një numër transaksionesh të pakontrolluara, ku secili është pothuajse njëlloj i krahasueshëm me transaksionin e kontrolluar, bazuar në një analizë krahasueshmërie të kryer në përputhje me nenin 36/1.

2. Një transaksion i kontrolluar ose një grup transaksionesh nuk do të jetë subjekt i rregullimeve, sipas pikës 3 të nenit 36, kur treguesi financiar përkatës, që rrjedh nga transaksioni/transaksionet i/e kontrolluar/a që po testohet/testohen sipas metodës më të përshtatshme të transferimit të çmimit, është brenda diapazonit të tregut.

3. Kur treguesi financiar përkatës, i cili rrjedh nga transaksione të kontrolluara, del jashtë diapazonit të tregut, administrata tatimore mund ta rregullojë atë sipas pikës 3 të nenit 36, dhe çdo rregullim i tillë do të jetë në mesataren e diapazonit të tregut, përveç rasteve kur administrata tatimore apo tatimpaguesi mund të vërtetojnë se rrethanat në atë rast garantojnë rregullimin në një pikë të ndryshme të gamës së tregut, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e ministrit të Financave.

Neni 36/5

Informacioni mbi transferimin e çmimit

1. Një tatimpagues duhet të paraqesë informacion dhe analiza të mjaftueshme për të vërtetuar se kushtet e transaksioneve të tij të kontrolluara janë në përputhje me parimet e tregut. Dokumentacioni i transferimit të çmimit duhet t'i vihet në dispozicion administratës tatimore, me kërkesë të saj, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së administratës tatimore. Përmbajtja dhe forma e dokumentacionit të transferimit të çmimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

2. Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara mbi një vlerë të përcaktuar duhet të paraqesin një njoftim/formular vjetor për transaksionet e kontrolluara. Ministri i Financave përcakton, me udhëzim, kufirin/vlerën e sipërpërmendur, formatin dhe afatin kohor për paraqitjen e informacionit mbi transaksionet e kontrolluara.

Neni 36/6

Rregullimet korresponduese

Kur në kushtet e transaksioneve të kontrolluara bëhet një rregullim nga një administratë tatimore e një vendi

tjetër dhe ky rregullim rezulton në taksimin në atë vend të fitimeve, për të cilat tatimpaguesi është tatuar tashmë në Shqipëri, dhe vendi që propozon rregullimin ka një marrëveshje me Shqipërinë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, atëherë, në këto kushte, administrata tatimore e Shqipërisë, pas kryerjes së një kërkesë nga tatimpaguesi shqiptar, do të kontrollojë përputhshmërinë e atij rregullimi me parimet e tregut, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 36. Nëse administrata tatimore arrin në përfundimin që rregullimi është në përputhje me parimet e tregut, ajo bën rregullimet e duhura në vlerën e tatimit që i është ngarkuar tatimpaguesit shqiptar. Procedura për kërkesën për një rregullim korrespondues, sipas këtij neni, do të përcaktohet në udhëzimin e ministrit të Financave.

Neni 36/7

Marrëveshjet e çmimit në avancë

1. Një tatimpagues mund të kërkojë që administrata tatimore të hyjë në një marrëveshje çmimi në avancë për të përcaktuar një grup të përshtatshëm kriteresh për përputhshmërinë me parimin e tregut për transaksionet e ardhshme të kontrolluara për një periudhë kohore të përcaktuar.

2. Kur administrata tatimore hyn në një marrëveshje çmimi në avancë me një tatimpagues, asnjë rregullim i transferimit të çmimit nuk bëhet sipas pikës 3 të nenit 36, për transaksionet e kontrolluara që janë brenda fushës së marrëveshjes, për aq kohë sa afatet dhe kushtet e vendosura nga marrëveshja e çmimit në avancë janë plotësuar.

3. Ngarkohet ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi të posaçëm në lidhje me marrëveshjet e çmimit në avancë.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8563, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 43/2014

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 115 shtohet neni 115/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 115/1

Dënime lidhur me transferimin e çmimit

1. Në rast të mosparaqitjes në kohë të "Njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara", në përputhje me dispozitat përkatëse të udhëzimit të Ministrit të Financave, "Për transferimin e çmimit", tatimpaguesi dënohet me një gjobë fikse prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, për çdo muaj vonesë.

2. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, për efekt të transferimit të çmimit në bazë të dispozitave të nenit 36 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, tatimpaguesit dënohen sipas nenit 114, "Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit", të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Në rast rregullimesh të detyrimeve tatimore, për efekt të transferimit të çmimit, në bazë të dispozitave të nenit 36 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ndaj tatimpaguesve, të cilët kanë plotësuar dhe kanë paraqitur në organet tatimore dokumentacionin e transferimit të çmimit, siç përcaktohet në nenin 36/5 të ligjit të sipërpërmendur, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, "Për transferimin e çmimit", këta tatimpagues janë të detyruar të paguajnë vetëm detyrimin shtesë dhe interesat, por jo gjoba."

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8564, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 44/2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 9367, DATË 7.4.2005, "PËR
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE
PUBLIKE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 21, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

"1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues, të parashikuar në nenin 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut III, seksioni 2, të këtij ligji, ndalimi sipas paragrafit të parë të kësaj pike, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuar në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë."

Neni 2

Në nenin 24, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenet 21 dhe 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es."

Neni 3

Në nenin 31, paragrafi i parë, ndryshohet si më poshtë:

"Zyrtari i nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit të shërbimit civil, zyrtari i nivelit të lartë e të mesëm të Policisë së Shtetit dhe të Forcave të Armatosura, sipas sistemit të gradave dhe detyrave të

zbatueshme për këto institucione publike, zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm, të barasvlershëm me zyrtarët në pozicionet drejtor drejtorie, drejtor drejtorie të përgjithshme dhe titullarë të enteve rregullatore (dhe ata, sipas nenit 30 të këtij ligji) apo institucioneve të tjera të administratës publike, që nuk janë pjesë e shërbimit civil, si dhe prefekti.”.

Neni 4

Në nenin 35, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Person i lidhur, për qëllim të neneve 27 deri në 33 të këtij ligji, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet e tjera të këtij seksioni, janë vetëm bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.”.

Neni 5

Në nenin 42, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Autoritetet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 41 të këtij ligji, mbledhin dhe i dërgojnë Inspektoratit të Lartë deklaratat e plotësuara të interesave privatë para fillimit të detyrës, pas largimit nga funksioni, brenda 15 ditëve nga përmbushja e afatit ligjor për dorëzimin e këtyre deklaratave nga subjekti.

Deklaratat periodike vjetore i dërgohen Inspektoratit të Lartë brenda datës 15 prill të çdo viti. Autoritetet përgjegjëse njoftojnë Inspektoratin e Lartë për rastet e mosdeklarimeve.

Këto autoritete mbështesin e kryejnë detyrat e ngarkuara nga Inspektori i Përgjithshëm për lehtësimin dhe zhvillimin e frytshëm të procesit të deklarimit periodik të interesave, si dhe rasteve të konfliktit të interesave. Ato i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarimin periodik.

Mbi bazën e raportit vjetor, Inspektori i Përgjithshëm harton vlerësime dhe rekomandime lidhur me zbatimin e këtij ligji nga autoritetet përgjegjëse dhe institucionet publike.

Në përshkrimin e pozicionit të punës, për detyrën e autoritetit përgjegjës, vendosen kritere dhe për njohjen e ligjeve për deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave.

Për emërimin, lëvizjen apo largimin nga funksioni të autoriteteve përgjegjëse, njoftohet paraprakisht Inspektori i Përgjithshëm.”.

Neni 6

Pas nenit 43 shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 43/1

Deklaratat për konfliktin e interesave dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8565, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**LIGJ
Nr. 46/2014**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR
ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
NDËRTIMIT TË RRUGËS TIRANË - ELBASAN -
QUKËS - QAFË E PLOÇËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit të ndërtimit të rrugës Tiranë - Elbasan - Qukës - Qafë e Ploçës, nëpërmjet një huaje prej 93 750 000 (nëntëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) saudi riyals (ekuivalent me 25 000 000 US\$).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8567, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE HUAJE

PROJEKTI I NDËRTIMIT TË RRUGËS TIRANË – ELBASAN – QUKËS - QAFË PLOÇË NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Marrëveshje e datës 18 Rabi II 1434 A.H., që përputhet me 18 shkurt 2014 A.D, ndërmjet:

1. Fondit Saudit për Zhvillim, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (më poshtë quhet “Fondi”), përfaqësuar nga SHT. Ing. Mohammed Suliman Alarif, zëvendëskryetar dhe këshilltar i Drejtorit Menaxhues për Projektet;

dhe

2. Republikës së Shqipërisë (më poshtë quhet “Huamarrësi”), përfaqësuar nga SHT. z. Shkëlqim Cani, ministër i Financave.

PREAMBULË

A) *Ndërsa Huamarrësi* i ka kërkuar Fondit dhënien e një Huaje për të asistuar financimin e Projektit të Ndërtimit të Rrugës Tiranë – Elbasan – Qukës – Qafë Ploçë, të përshkruar në skedulim nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (më poshtë quhet “Projektit”);

B) *Ndërsa Huamarrësi* ka marrë nga Banka Islamike për Zhvillim (më poshtë quhet “Banka Islamike”) një hua në një shumë prej 347.700.000 dollarësh amerikanë, për të asistuar në financimin e një pjese të kostos së Projektit me termat dhe kushtet e parashikuara në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës Islamike (më poshtë quhet “Marrëveshje e Huas së Bankës Islamike”);

C) *Ndërsa Huamarrësi* ka marrë nga Fondi Abu Dhabi për Zhvillim (më poshtë quhet “Fondi Abu Dabi”) një hua në një shumë prej 50.000.000 dollarësh amerikanë për të asistuar në financimin e një pjese të kostos së Projektit me termat dhe kushtet e parashikuara në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit Abu Dabi (më poshtë quhet “Marrëveshje e Fondit Abu Dabi”);

D) *Ndërsa Huamarrësi* ka marrë nga Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (më poshtë quhet “OFID”) një hua në një shumë prej 20.400.000 dollarësh amerikanë për të asistuar në financimin e një pjese të kostos së Projektit me termat dhe kushtet e parashikuara në Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe OFID-it (më poshtë quhet “Marrëveshje e Huas së OFID-it”);

E) *Ndërsa qëllimi* i Fondit është të asistojë vendet në zhvillim të zhvillojnë ekonomitë e tyre dhe t’i pajisë ata me huat e kërkuara për zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit;

F) *Ndërsa Fondi* është i bindur për rëndësinë e Projektit dhe efektet e tij përfutuese për zhvillimin ekonomik të popullit mik të Shqipërisë; dhe

G) *Ndërsa Bordi i Drejtorëve të Fondit* ka rënë dakord, duke pasur parasysh sa më sipër, nëpërmjet rezolutës së tij nr. 10/102/1199 dhe rezolutës nr. 5/1434 për t’i dhënë Huamarrësit një hua me termat dhe kushtet e parashikuara këtu.

Kështu, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e Përgjithshme; përkufizime

Seksioni 1.01. Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e Kushteve të Përgjithshme të Zbatueshme për marrëveshjet e Huas së Fondit të nxjerra me rezolutën e Bordit të Drejtorëve të Fondit nr. 11/14, të datës Rajab 29, 1396AH, që përputhet me 26 korrikun 1976 AD, me të njëjtën fuqi sikur të ishin parashikuara këtu (këto Kushte të Përgjithshme të Zbatueshme për marrëveshjet e Huas të Fondit më poshtë quhen “Kushte të Përgjithshme”).

Seksioni 1.02. Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuar në Kushtet e Përgjithshme dhe në preambulën e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të parashikuara në të, dhe termi “Ministria” nënkupton Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës të Huamarrësit dhe “Agjencia Zbatuese” nënkupton Autoritetin Shqiptar të Rrugëve nën Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Neni 2

Huaja

Seksioni 2.01. Fondi bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së Huas, të parashikuara ose referuar, një hua në një shumë prej nëntëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë (93.750.000) riyalë sauditë.

Seksioni 2.02. Huamarrësi do të ketë të drejtën të tërheqë shumën nga llogaria e Huas në pajtim me dispozitat e skedulit nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, ku ky skedul mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit, dhe në pajtim me procedurat për tërheqjen e Huave të Fondit Saudit për Zhvillim, për shpenzimet e bëra ose (nëse Fondi për këtë bie dakord), që do të bëhen në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe të shërbimeve që kërkohen për Projektin dhe që financohen nga shumat e Huas.

Seksioni 2.03. Huamarrësi merr përsipër të përdorë shumat e Huas vetëm për financimin e kostos së arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve, që kërkohen për përmbushjen e Projektit. Prokurimi i këtyre mallrave, punëve dhe shërbimeve do të jetë në pajtim me udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe kontraktimin për ekzekutimin e punëve dhe përdorimin e konsulentëve të anëtarëve të instituteve për zhvillim të grupit të

koordinimit. Huamarrësi do të marrë aprovimin e Fondit para dhënies së kontratave që do të financohen nga shumat e Huas dhe para kryerjes së ndonjë modifikimi thelbësor të ardhshëm në ndonjë prej tyre.

Seksioni 2.04. Data e mbylljes do të jetë 28.2.2018 ose një datë e mëvonshme që përcaktohet nga Fondi. Fondi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do të paguajë një tarifë Huaje në normën prej 2% (dy për qind) në vit për shumën principale të Huas së tërhequr dhe të pashlyer herë pas here.

Seksioni 2.06. Tarifa e Huas dhe tarifat e tjera do të paguhet dy herë në vit, më 20 mars dhe 20 shtator të çdo viti.

Seksioni 2.07. Afati i Huas është 25 vjet, duke përfshirë një afat prej 5 vjetësh pa pagesë principale. Huamarrësi shlyen shumën principale të Huas në pajtim me grafikun e amortizimit të parashikuar në skedulën nr. 3 të kësaj Marrëveshjeje. Secili këst paguhet së bashku me tarifën e Huas dhe tarifat e tjera, me një njoftim 45-ditor që i drejtohet Huamarrësit nga Fondi para datës së kërkueshme.

Neni 3

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01. a) Huamarrësi do të zbatojë Projektin nëpërmjet Ministrisë, me kujdesin dhe eficiencën e duhur dhe në pajtim me praktikën e duhur administrative, financiare dhe inxhinierike dhe do të ofrojë, kur kërkohen, fondet, mjetet, shërbimet dhe të gjitha burimet e tjera që kërkohen për zbatimin e Projektit.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit "a" të këtij seksioni, Huamarrësi: 1) do të ofrojë në kohën e duhur të gjitha fondet e tjera, që do të kërkohen për realizimin e Projektit (duke përfshirë fondet që mund të kërkohen për të përmbushur çdo rritje të kostos së tij tej kostos së vlerësuar në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje); nëse këto shuma duhet të ofrohen nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Huamarrësit dhe një pale të tretë, termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë të pranueshëm për Fondin; 2) do të bëjë alokimet e përshtatshme buxhetore vjetore për të mbuluar pjesën e vet të kostove të Projektit; dhe 3) do të mbështesë çdo kosto shtesë që kalon shumën e Huas dhe të nevojshme për përmbushjen e Projektit.

Seksioni 3.02. Huamarrësi do të marrë masa që Ministria t'i paraqesë Fondit menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, raportet, dokumentet e kontratës dhe grafikët e ndërtimit dhe të prokurimit të Projektit dhe, çdo ndryshim të tyre ose shtesë në to, me ato hollësi që Fondi kërkon në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 3.03. Për mbikëqyrjen e ekzekutimit të Projektit, Huamarrësi do të ketë inxhinierë konsulentë,

kualifikimet dhe eksperiencën e të cilëve janë të pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.04. Në përmbushjen e Projektit, Huamarrësi do të punësojë kontraktorë të pranueshëm për Fondin me termat dhe kushtet e pranueshëm për Fondin.

Seksioni 3.05. Huamarrësi do të marrë masa që mallrat e importuara, që financohen nga shumat e Huas, të sigurohen ndaj rreziqeve në lidhje me përfundimin, transportimin dhe dorëzimin e tyre në vendin e përdorimit ose të instalimit dhe, për këtë sigurim, çdo zhdëmtim do të jetë i pagueshëm në një monedhë lirisht të përdorshme nga Huamarrësi për të zëvendësuar ose riparuar këto mallra.

Seksioni 3.06. Huamarrësi do të marrë masa që të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga shumat e Huas të përdoren ekskluzivisht për përmbushjen e Projektit.

Seksioni 3.07. Huamarrësi do të marrë masa që Ministria:

a) të mbajë regjistra të përshtatshëm për regjistrimin e përparimit të Projektit (duke përfshirë koston e tyre), për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumat e Huas dhe të deklarojë përdorimin e tyre në Projekt dhe të reflektojë të gjitha operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me Projektin;

b) të përballojë të gjithë mundësinë e arsyeshme për përfaqësuesit e akredituar të Fondit për të bërë vizita për qëllimet në lidhje me Huan, të shqyrtojnë Projektin, mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumat e Huas dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës;

c) t'i paraqesë Fondit atë informacion që Fondi kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me Projektin, shpenzimin e shumave të Huas, dhe mallrat dhe shërbimet e financuara nga këto shuma.

Seksioni 3.08. Huamarrësi do të marrë masa që Ministria të ndërmarrë të gjitha ato veprime që do të jenë të nevojshme për të përfunduar në mënyrën dhe kohën e duhur të gjithë tokën dhe të drejtat në lidhje me tokën që do të kërkohen për të përmbushur Projektin.

Neni 4

Angazhime të veçanta

Seksioni 4.01. a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë marrëveshjen e tyre që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të gëzojë ndonjë prioritet tjetër mbi Huan nëpërmjet një barre të vendosur në sendet pasurore qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, përveç kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse duhet të vendoset një barrë në sendet pasurore të Huamarrësit si garanci për çdo borxh të jashtëm, një barrë e tillë *ipso facto* dhe pa asnjë kosto për Fondin garanton njëkohësisht dhe proporcionalisht pagesën e principalit të Huas, tarifës së Huas dhe tarifave të tjera të Huas dhe që në krijimin e

një barre të tillë do të bëhet një parashikim shprehimisht për këtë qëllim.

b) Angazhimi i parashikuar në paragrafin “a” të këtij seksioni nuk do të zbatohet për:

i) çdo barrë e krijuar mbi pronën, në momentin e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj prone;

ii) çdo barrë mbi mallrat tregtare për të garantuar një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës në të cilën shkaktohet fillimisht dhe që paguhet nga shumat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

iii) çdo barrë që lind në vazhden e zakonshme të transaksioneve bankare dhe që siguron një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së saj.

Seksioni 4.02. Huamarrësi do të mbajë ose do të marrë masa për mbajtjen e regjistrave të përshtatshëm për të reflektuar në pajtim me praktikën e shëndosha të llogarive, operacioneve, burimeve dhe shpenzimeve në lidhje me Projektin e Ministrisë dhe departamenteve, dhe agjencive të tjera të Huamarrësit, përgjegjëse për përmbushjen e Projektit ose një pjese të tij.

Seksioni 4.03. Huamarrësi do të mbajë sigurim për Projektin ndaj atyre risqeve dhe në ato shuma që do të jenë në përputhje me praktikën e përshtatshme në pajtim me rregulloren në fuqi në vendin e tij.

Seksioni 4.04. Huamarrësi merr përsipër të bëjë një pllakë kujtesë me dimensione të përshtatshme në beton ose në një metal tjetër të përshtatshëm që duhet të fiksohet në një vend të dukshëm në një prej kantierëve të përfshira në Projekt, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e Projektit.

Seksioni 4.05. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë mirëmbajtjen e përgjithshme të Projektit, duke realizuar inspektime periodike në pajtim me parimet e përshtatshme inxhinierike dhe të parashikojë shumat e nevojshme për këtë qëllim në buxhetin vjetor. Huamarrësi ndërmer, gjithashtu, t'i paraqesë Fondit planin e miratuar të mirëmbajtjes, si ta kërkojë Fondit.

Seksioni 4.06. Huamarrësi merr përsipër të realizojë çdo modifikim në Projekt vetëm me aprovimin paraprak të Fondit.

Seksioni 4.07. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që dimensionin dhe ngarkesat për aks të automjeteve, që përdorin rrugën, nuk i kalojnë limitet që janë në pajtim me standardet e projektimit strukturor dhe gjeometrik të rrugës.

Seksioni 4.08. Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në asnjë rast më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes, ose në një datë tjetër të mëvonshme që Fondi mund të bjerë dakord për këtë qëllim, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Fondit një raport të përfundimit të Projektit, në formë dhe hollësi të arsyeshme, sipas kërkesës së Fondit, për ekzekutimin dhe operimin fillestar të Projektit, kostot

dhe përfitimet e nxjerra dhe që do të nxirren prej tij, përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Huas dhe arrijten e objektivave të Huas.

Neni 5

Masat mbrojtëse të Fondit

Seksioni 5.01. Për qëllimet e seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme, ngjarjet e mëposhtme shtesë specifikohen në pajtim me paragrafin “f” të tyre:

a) Në pajtim me nënseksionin “b” të këtij seksioni:

i) e drejta e Huamarrësit të tërheqë shumat e çdo huaje ose grandit të dhënë Huamarrësit për financimin e Projektit do të jetë pezulluar, anuluar ose përfunduar plotësisht ose pjesërisht, në pajtim me termat e Marrëveshjes që parashikojnë këtë; ose

ii) një hua e tillë është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme para maturimit të rënë dakord për të.

b) Nënseksioni “a” i këtij seksioni nuk do të zbatohet nëse Huamarrësi vërteton në mënyrë të pranueshme për Fondin, që: i) ky pezullim, anulim, përfundim ose paramaturim nuk është shkaktuar nga mospërmbushja e Huamarrësit në kryerjen e një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe ii) fonde të përshtatshme për Projektin i ofrohen Huamarrësit nga burime të tjera me termat dhe kushtet në pajtim me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve të Përgjithshme, ngjarja e mëposhtme specifikohet në pajtim me paragrafin “d” të tyre, që do të thotë se ngjarja e specifikuar në nënseksionin “a”/(ii) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë dhe do të vazhdojë brenda një periudhe që kalon 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data në të cilën Fondi këshillon Huamarrësin për ndodhinë e kësaj ngjarjeje.

Neni 6

Data e hyrjes në fuqi, zgjidhja

Seksioni 6.01. Periudha prej 6 muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, specifikohet për qëllimet e seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 7

Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimin e seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Fondin:

Fondi Saudit për Zhvillim

P.O.Box 50483

Riyadh 11523

Kingdom of Saudi Arabia

Tel.: +966-1-2794000

Fax.: +966-1-4647450

e-mail: info@sfd.gov.sa

Për Huamarrësin:

1. Ministria e Financave

Dëshmorët e Kombit, nr. 1

Tiranë, Republika e Shqipërisë

Tel.: + 35542228405

Fax.: + 35542228494

e-mail: sekretariamin@minfin.gov.al

2. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Sheshi "Skënderbej", nr. 5

Tiranë, Republika e Shqipërisë

Tel.: + 35542234647

Fax.: + 35542232389

3. Agjencia Zbatuese

Autoriteti Shqiptar i Rrugëve

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Rruga "Sami Frashri", nr. 33

Tiranë, Republika e Shqipërisë

Tel.: + 35542234702

Fax.: + 35542223600

Në dëshmi të kësaj, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre përkatës, në qytetin e Tiranës, Republika e Shqipërisë, në ditën, muajin dhe vitin e shkruar më sipër, në dy kopje në gjuhët arabe dhe angleze, secila prej të cilave është kopje origjinale dhe një kopje e Kushteve të Përgjithshme në të dyja gjuhët i është dhënë Huamarrësit, me kusht që nëse një dispozitë e versionit arab të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme është në mospërputhje me një dispozitë të versionit anglez të Marrëveshjes së Huas dhe/ose Kushteve të Përgjithshme, mbizotëron versioni arab.

PËR FONDIN SAUDIT PËR ZHVILLIM

Mohammad Suliman Alarifi

Zëvendëskryetar dhe Këshilltar i Drejtorit
Manaxhues për Projektet

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

SKEDULI NR. 1 TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUAS

Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e artikujve që do të financohen nga shumat e Huas, alokimet e shumave të Huas për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që financohen për artikujt në çdo kategori.

Kategoria		Shuma e Huas së alokuar (shprehur në riyalë sauditë)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1	Punë civile ("B-3" i parë) i Projektit	81.937.500	100% e shpenzimeve të plota
2	Shërbime të konsulencës ("d" e dytë) e Projektit	3.300.000	100% e shpenzimeve të plota
3	Të paalokuara	8.512.500	
TOTALI		93.750.000	

B) Pavarësisht dispozitave të paragrafit "A" të mësipërm, asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me pagesat e bëra për:

1. Shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe

2. Taksat e vendosura nga ose në territorin e Huamarrësit mbi mallrat ose shërbimet, ose mbi importin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre.

C) Pavarësisht alokimit të një shume të Huas ose përqindjes së disbursimit të përcaktuar në tabelën në paragrafin "A" më sipër, nëse Fondi ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme që shumat e Huas e alokuar në kategorinë do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord për të gjitha shpenzimet në këtë kategori, Fondi, nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit, mund të:

i) rialokojë në këtë kategori, në masën e kërkuar, për të përmbushur diferencën e vlerësuar, shumat e Huas që janë të paalokuara dhe që, në mendimin e Fondit, nuk nevojiten për të përmbushur shpenzime të tjera; dhe

ii) nëse ky rialokim nuk mund të përmbushë plotësisht diferencën e vlerësuar, ul përqindjen e disbursimit të zbatueshme për këto shpenzime, në mënyrë që tërheqjet e tjera, sipas kësaj kategorie, të mund të vazhdojnë derisa të bëhen të gjitha shpenzimet sipas saj.

**SKEDULI NR. 2
PËRSHKRIMI I PROGRAMIT**

Projekti synon të sigurojë lidhjen më të shkurtër rrugore ndërmjet kryeqytetit dhe fshatrave të izoluar me vendet fqinje jugore, si dhe të përmbushë kërkesat e tashme dhe të ardhshme të transportit, të përmirësojë rrugët për të tërhequr turizmin dhe biznesin. Projekti përbëhet nga sa më poshtë:

Së pari: - Punët civile, që përfshijnë dy pjesë:

A) Pjesa e parë: Rruga Tiranë – Elbasan.

Ndërtimi i rrugës së re me dy korsi në çdo drejtim nga kryeqyteti (Tirana) për në qytetin e Elbasanit, me gjatësi 27 km dhe 28.2 m gjerësi të përgjithshme, duke përfshirë tunelin me dy korsi, me gjatësi 2.2 km dhe 9 m gjerësi për çdo anë.

B) Pjesa e dytë: Rruga Qukës – Qafë Plloçë.

Ndërtimi i një rruge 43.4 km të gjatë me dy korsi, që përfshin një tunel 375 m të gjatë me dy kalime. Rruga do të ketë dy korsi trafiku 3.75 m të gjera, 1.5 metra anët e shtruara dhe 1.0 metër anë të pashtuara në çdo anë. Përbëhet nga seksionet e mëposhtme:

Seksioni 1: Nga fillimi deri në pikën 2.9 km.

Seksioni 2: Nga pika 2.9 km deri në pikën 33.8 km, duke përfshirë një tunel me dy korsi 375 m të gjatë.

Seksioni 3: Nga pika 33.8 deri në pikën 43.4 km (fundi i Projektit).

Së dyti: Shërbimet e konsulencës për Projektin

Përgatitja dhe rishikimi i Projektit, përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe mbikëqyrja e Projektit, si më poshtë:

a) Shërbimet e konsulencës për pjesën e parë të Projektit;

b) Shërbimet e konsulencës për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 1);

c) Shërbimet e konsulencës për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 2);

d) Shërbimet e konsulencës për pjesën e dytë të Projektit (seksioni 3).

Së treti: - Blerja e tokës

Së katërti: - Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)

Kostoja totale e Projektit është rreth 487.8 milionë dollarë amerikanë, që është e barabartë me 1.8 bilionë SR dhe Projekti pritet që të përfundohet në fund të vitit 2016.

**SKEDULI NR. 3
GRAFIKU I AMORTIZIMIT**

Nr. i kështit	Data e pagesës	Shuma e kështit shprehur në riyalë sauditë
1.	20 mars 2019	2,334,000
2.	20 shtator 2019	2,334,000
3.	20 mars 2020	2,334,000
4.	20 shtator 2020	2,334,000
5.	20 mars 2021	2,334,000
6.	20 shtator 2021	2,334,000
7.	20 mars 2022	2,334,000
8.	20 shtator 2022	2,334,000
9.	20 mars 2023	2,334,000
10.	20 shtator 2023	2,334,000
11.	20 mars 2024	2,334,000
12.	20 shtator 2024	2,334,000
13.	20 mars 2025	2,334,000
14.	20 shtator 2025	2,334,000
15.	20 mars 2026	2,334,000
16.	20 shtator 2026	2,334,000
17.	20 mars 2027	2,334,000
18.	20 shtator 2027	2,334,000
19.	20 mars 2028	2,334,000
20.	20 shtator 2028	2,334,000
21.	20 mars 2029	2,334,000
22.	20 shtator 2029	2,334,000
23.	20 mars 2030	2,334,000
24.	20 shtator 2030	2,334,000
25.	20 mars 2031	2,334,000
26.	20 shtator 2031	2,334,000
27.	20 mars 2032	2,334,000
28.	20 shtator 2032	2,334,000
29.	20 mars 2033	2,334,000
30.	20 shtator 2033	2,334,000
31.	20 mars 2034	2,334,000
32.	20 shtator 2034	2,334,000
33.	20 mars 2035	2,334,000
34.	20 shtator 2035	2,334,000
35.	20 mars 2036	2,334,000
36.	20 shtator 2036	2,334,000
37.	20 mars 2037	2,334,000
38.	20 shtator 2037	2,334,000
39.	20 mars 2038	2,334,000
40.	20 shtator 2038	2,334,000
TOTALI		93.750.000

LIGJ
Nr. 48/2014

PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET
KONTRAKTORE E TREGTARE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave ligjore për pagesat e vonuara, në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe, në veçanti, të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Neni 2
Fusha e zbatimit të ligjit

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera si kundërpaguesë për veprimet juridike tregtare. Nuk i nënshtrohen rregullimeve të këtij ligji detyrimet apo pagesat:

- a) që janë objekt i procedurës së falimentimit të çelur kundër debitorit, përfshirë edhe procedurën me objekt ristrukturimin e borxhit;
- b) që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët;
- c) që lidhen me interesin apo pagesat e tjera të kryera për titujt;
- ç) që lidhen me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, përfshirë edhe pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Veprimi juridik tregtar” është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare, nga njëra

anë, dhe autoriteteve publike, nga ana tjetër, të cilat çojnë në livrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpaguese.

2. “Autoritet publik” është çdo autoritet kontraktues shtetëror, si njësi e qeverisjes së përgjithshme, ku përfshihen njësitë e qeverisjes qendrore, vendore dhe të fondeve speciale.

3. “Sipërmarrje tregtare” është çdo person juridik, i krijuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me përjashtim të një autoriteti publik, i cili vepron në kuadër të veprimtarisë së tij të pavarur ekonomike a profesionale.

4. “Pagesë me vonesë” është pagesa që nuk kryhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, nga ana e sipërmarrjes tregtare dhe e autoritetit publik, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

5. “Pagesë me vonesë e thesarit” është pagesa që nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar me kontratë a me ligj, kur janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, por kur ka gjendje me mungesë likuiditeti në llogarinë e unifikuar të thesarit pas datës së regjistrimit në sistemin informatik financiar të qeverisë.

6. “Sistem i thesarit”, ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

7. “Kamatëvonesë ligjore për pagesën me vonesë” është kamatëvonesa e parashikuar nga ligji për pagesën me vonesë, me normë interesi të barabartë me shumën e normës bazë të interesit për lekun ose normës bazë të interesit për zonën euro, apo normës bazë të interesit në monedhë të huaj dhe, të paktën, tetë pikë përqindjeje dhe që llogaritet sipas nenit 5 të këtij ligji.

8. “Marrëveshje riblerjeje (REPO)” është marrëveshja, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet titujt, duke marrë përsipër t’i blejë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim zvogëlimin e përkohshëm të likuiditetit në sistemin bankar.

9. “Marrëveshje e anasjellë riblerjeje (REPO të anasjella)” është marrëveshja, me anën e së cilës Banka e Shqipërisë blen titujt, duke marrë përsipër t’i shesë ato sipas kushteve për të cilat është rënë dakord paraprakisht me një bankë ose degë të bankës së huaj, me qëllim rritjen e përkohshme të likuiditetit në sistemin bankar.

10. “Norma bazë e interesit për lekun” është norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2011/7/EU, të Parlamentit Europian dhe Këshillit, të datës 16 shkurt 2011, “Për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare”; Celex: 32011L000, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.

11. “Norma bazë e interesit për zonën euro” është norma e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane.

12. “Norma bazë e interesit në monedhë të huaj” është norma e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit, të miratuara nga organet kompetente të bankave qendrore, e cila emeton monedhën në të cilën është bërë pagesa.

13. “Shuma për t’u paguar” është principi që duhej të ishte paguar brenda afatit ligjor ose kontraktor të pagesës, duke përfshirë tatimet, taksat, tarifatat a detyrimet e zbatueshme, të përcaktuara në faturë ose në kërkesën e njëvlershme për pagesë.

14. “Urdhër ekzekutiv” është urdhri për vënien në ekzekutim të titujve të ekzekutimit, sipas nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 4

Veprimet juridike ndërmjet sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike

Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t’i dërguar njoftim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur:

a) kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin;

b) kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t’u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjës për vonesën nuk është debitori.

Neni 5

Llogaritja e kamatëvonesës

1. Norma bazë e interesit për lekun, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella), miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit të vitit paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

2. Norma bazë e interesit për monedhën euro, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është:

Për gjashtëmujorin e parë të vitit, sa norma e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit të vitit

paraardhës, duke i shtuar tetë pikë përqindjeje, dhe për gjashtëmujorin e dytë, sipas normës së miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane në mbledhjen e fundit përpara datës 1 korrik të vitit korrent duke i shtuar tetë pikë përqindjeje.

3. Norma bazë e interesit për monedhat e tjera, e zbatueshme për llogaritjen e kamatëvonesës, është sipas llogaritjes në lekë të normës së interesit, duke marrë si kurs të llogaritjes në lekë të detyrimit, kursin e ditës që kërkohet pagesa e kamatëvonesës ligjore.

Neni 6

Afati

Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit Civil. Kreditorit, të cilit debitori nuk i ka kundërshtuar furnizimin me mallra apo shërbime, i lind e drejta për të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga dita e nesërme pas datës së afatit të pagesës, të përcaktuar në kontratë.

Në ato raste kur debitori ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;

b) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;

c) kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimin të mallrave ose shërbimeve, 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve;

ç) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Afati i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike.

Afatet kontraktore për kryerjen e pagesave nuk mund të jenë më të gjata se 60 ditë nga data e parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni. Në ato raste kur me kontratë apo në marrëveshje me palët është caktuar një afat tjetër, ky afat konsiderohet i vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur dëmton dhe vë në pozitë diskriminuese kreditorin.

Neni 7

Afati për autoritetet publike

Në veprimet juridike tregtare, në të cilat debitori është autoritet publik, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, dhe:

a) kur kreditori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, sipas ligjit dhe kontratës;

b) kur kreditori nuk është paguar, me përjashtim të rastit kur vonesa nuk ka ardhur për faj të debitorit;

c) kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, afati i pagesës nuk duhet të jetë më i gjatë se:

i) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes nga ana e debitorit të faturës ose të një kërkesëpagese të njëvlershme;

ii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;

iii) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimit të mallrave ose shërbimeve;

iv) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën, dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date.

Në ato raste kur ndërmjet kreditorit dhe debitorit ka një datë të përcaktuar për dorëzimin e faturës, afatet për pagimin e kamatëvonesave fillojnë të llogariten që nga e nesërmja e datës së përcaktuar në marrëveshje.

Afati i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur në kontratë apo marrëveshje është rënë dakord për një afat tjetër.

Në ato raste kur autoriteti publik ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori.

Afati i parashikuar në paragrafin e parë, të këtij neni, i jep të drejtë kreditorit të kërkojë të marrë kamatëvonesë pas 60 ditëve kalendarike gjithsej, duke përfshirë 30 ditët kalendarike të vonesës nga thesari, në shtesë nga 30 ditët e vonesës së pagesës për shkak të autoritetit publik.

Neni 8

Zgjatja e afateve për autoritetet publike

Afatet e parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, nuk zbatohen për sa i përket pagesave të vonuara për veprimet juridike tregtare, të kryera me autoritete publike që ofrojnë shërbime në fushën e kujdesit shëndetësor. Në këto raste afatet nuk mund të jenë më të gjata se një vit kalendarik, duke filluar nga data kur ka lindur e drejta për të kërkuar kryerjen e pagesës për shitjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve.

Neni 9

Pagesat me këste

Për pagesat të cilat, sipas marrëveshjes së palëve, është parashikuar që të kryhen në periudha kohore të ndryshme, nëse ndonjëri prej kësteve nuk paguhet brenda datës për të cilën është rënë dakord, kamatëvonesa dhe dëmshpërblimi i parashikuar në këtë ligj llogariten në bazë të vlerave për këstin, të cilit i ka kaluar afati i kryerjes së pagesës.

Neni 10

Afatet e marrjes në dorëzim të mallrave

Në ato raste kur, nga kontrata ose marrëveshja e palëve, është parashikuar që mallrat do të merren sipas një procedure dorëzimi apo në rastet kur duhet të bëhet kolaudimi i tyre, afati i marrjes në dorëzim apo i kolaudimit të mallrave nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë kalendarike. Ky afat fillon të llogaritet nga e nesërmja e mbërritjes së mallit në destinacionin e përcaktuar nga blerësi.

Nëse në kontratën apo marrëveshjen e palëve është përcaktuar një afat tjetër, i ndryshëm nga ai i parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ky afat do të quhet i vlefshëm, me kusht që, nisur nga natyra e mallit apo nga praktika tregtare, të mos jetë në dëm të interesave të kreditorit dhe të mos e vërë këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Neni 11

Shpërblimi i shpenzimeve për rikthimin e kredisë

Kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori jo vetëm pagimin në favor të tij të kamatëvonesës për moskryerjen e pagesës në afat, por edhe pagimin e të gjitha shpenzimeve të kryera prej tij për rikthimin e kredisë, shpenzime këto të kryera për shkak të pagesës me vonesë, përveç rasteve kur debitori nuk është në faj për vonesën.

Shpenzimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni llogariten si kosto shtesë ndaj shumës që ka lindur për shkak të pagesës së vonuar dhe përfshijnë çdo shpenzim të provuar të kreditorit, që ai ka kryer kundrejt avokatëve, shpenzime të tjera ligjore të kryera për të bërë të mundur arkëtimin e pagesës, si dhe çdo shpenzim të paguar prej tij për të vënë në ekzekutim pagimin e shumës së detyrimit.

Neni 12

Pagimi i shpenzimeve

Në rastin e pagesës së vonuar, debitori ka detyrimin për të paguar në favor të kreditorit, përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, edhe një dëmshpërblim në shumën prej 5 000 (pesë mijë) lekësh. Kjo shumë është e pagueshme menjëherë, pa qenë nevoja e kryerjes së ndonjë njoftimi nga kreditori për pagimin e saj.

Neni 13

Kushtet kontraktore

Çdo marrëveshje që përjashton palët nga detyrimi për pagimin e kamatave, në rastet e pagesës së vonuar, është e pavlefshme.

Janë të padrejta dhe nuk krijojnë efekte juridike ato kushte kontraktore në lidhje me kushtet, afatet apo norma të tjera për llogaritjen e kamatëvonesave, si dhe për mospagimin e shpenzimeve për rikthimin e kredisë, sipas përcaktimeve të nenit 11 të këtij ligji, për aq kohë sa ato sjellin një dëmtim të shpërpjesëtuar të interesave të kreditorit dhe e vendosin këtë të fundit në një pozitë diskriminuese.

Për konstatimin e një kushti të padrejtë, sipas paragrafit të mësipërm, i cili përkeqëson gjendjen e kreditorit, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë:

a) çdo shmangie thelbësore nga praktika e mirë tregtare, e cila bie ndesh me parimet e mirëbesimit dhe paanësisë;

b) natyrën e mallit apo të shërbimit, me të cilin është furnizuar debitori;

c) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shtyrjen e afateve të kontratës, sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 7 të këtij ligji; ose

ç) faktin nëse ka arsye objektive që të sjellë për pasojë shmangien në kryerjen e pagesës së parashikuar në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 14

Pasojat e pavlefshmërisë së kushteve kontraktore

Në rast se një kusht kontraktor është i pavlefshëm, sipas nenit 13 të këtij ligji, kreditori ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për dëmin e ardhur nga zbatimi i këtyre kushteve.

Nëse palët i kanë paguar njëra-tjetrës pagesa të llogaritura tej normave të përcaktuara në këtë ligj, pala e cila ka kryer pagesën, ka të drejtën e ngritjes së padisë së

begatimit pa shkak, si dhe të kërimit të shpërblimit për dëmin e ardhur.

Neni 15

Detyrimet e sipërmarrjeve tregtare para hyrjes në fuqi të ligjit

Parashikimet e këtij ligji nuk do të zbatohen për detyrimet monetare që kanë të bëjnë me furnizimet e kryera për mallra dhe shërbime ndërmjet sipërmarrjeve tregtare të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, por që nuk janë përmbushur ende dhe që për to nuk kanë filluar procedurat për vënien në ekzekutim të tyre.

Për detyrimet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, për të cilat ka një vendim gjyqate, kreditori nuk ka të drejtë të kërkojë pagimin e kamatëvonesave dhe pagesave të tjera që lidhen me rikuperimin e pagesës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 16

Titulli ekzekutiv

1. Detyrimet monetare, të lindura nga veprimet juridike tregtare, të cilat nuk janë shlyer brenda afatit të pagesës përkatëse, sipas këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 485 i Kodit Civil, përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor, pavarësisht vlerës, kur:

a) kreditori ka lëvruar mallrat apo kryer shërbimet sipas kontratës dhe ligjit; dhe

b) debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin.

2. Në këto raste, detyrimi së bashku me kamatëvonesat dhe me shpërblimin për shpenzimet për rikthimin e kredisë mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

Neni 17

Detyrimet e autoriteteve publike para hyrjes në fuqi të ligjit

Për detyrimet e autoriteteve publike kundrejt ndërmarrjeve tregtare, të lindura dhe të paekzekutuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohen parashikimet e këtij ligji. Nuk mund të kërkojë zbatimi i parashikimeve të këtij ligji në rastet e ekzekutimit të detyrimeve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga ana e autoriteteve publike dhe të lindura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8568, datë 16.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr. 6/4, datë 16.5.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17,
DATË 13.5.2008, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E
SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, në paragrafin e tretë të pikës 8.6, “Diplomatët dhe organizatat ndërkombëtare”, që fillon me fjalinë “Pas verifikimit dhe miratimit të kërkesave për rimbursim, ...”, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Pas verifikimit dhe miratimit të kërkesave për rimbursim, Drejtoria Rajonale Tatimore i dërgon zyrtarisht Ministrisë së Punëve të Jashtme formularin nr. 3 “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së, një kopje e të cilit dërgohet zyrtarisht dhe në Thesar. Ministria e Punëve të Jashtme përpilon urdhërpagesën për rimbursim (në katër kopje), për çdo trup diplomatik, në bazë të formularit nr. 3 dhe e dërgon pranë Degës së Thesarit, ku kjo e fundit bën pagesat sipas legjislacionit në fuqi. Dega e Thesarit, pasi kontrollon përputhshmërinë e listës përmbledhëse, bashkëlidhur urdhër-pagesave me atë të formularit nr. 3, kryen pagesat me sistemin informatik financiar të qeverisë. Në fund të çdo muaji, Drejtoria Rajonale Tatimore, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Dega e Thesarit bëjnë rakordimet për pagesat e kryera gjatë periudhës mujore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

VENDIM
Nr. 4, datë 9.5.2014

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR
INFRASTRUKTURËN VENDORE, THIRRJA
E DYTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të infrastrukturës vendore, thirrja e dytë, në vlerën 1 200

000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të paraqesin pranë sekretariatit teknik për infrastrukturën vendore, në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, brenda një jave pas publikimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e të përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve, përpara çeljes së fondeve për projektet e miratuara sipas pikës 2 të këtij vendimi.

3. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014. Për fondet e projekteve të paprocuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të bëjnë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

TABELA 1. PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS VENDORE PËR FINANCIM NGA THIRRJA E DYTË

Nr	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera totale e projektit ⁽¹⁾	Vlera e financimit për 2014-ën
Qarku Berat				
1	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksioni i rrugës "Naftëtari"	125,758,849	89,031,199
Qarku Durrës				
2	Bashkia Durrës	Rikonstruksioni i mbikalimeve në Plepa dhe tek Ura e Dajlanit	137,000,000	105,900,000
3	Bashkia Durrës	Rikualifikim i nyjave hyrëse të qytetit të Durrësit etj.	67,304,912	57,113,442
Qarku Elbasan				
4	Bashkia Gramsh	Sistemimi dhe asfaltimi lagja "Sporti 1", sheshi afër tregut	29,134,239	20,393,969
Qarku Kukës				
5	Bashkia Kukës	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme Kukës, faza e parë	30,032,319	21,022,629
6	Bashkia Krumë	Ndërtim-asfaltim rrugë urbane, bashkia Krumë	19,641,253	13,748,883
Qarku Lezhë				
7	Bashkia Lezhë	Rikonstruksioni i urës hyrëse mbi lumin Drin në Lezhë	32,738,774	22,917,144
Qarku Tiranë				
8	Bashkia Tiranë	Rikualifikim urban, blloku i kufizuar mes rrugëve "D.Hima", SH.A.Pazari dhe stadiumi "Qemal Stafa"	60,000,000	50,637,960
9	Njësia bashkiake nr.1	Rikonstruksioni i Rrugës "Shote Galica" (zonë informale)	54,541,466	48,179,036
10	Bashkia Kavajë	Rruga e daljes (zona industriale), rikualifikim i plotë, (trotuare, asfalt etj.)	200,211,993	166,055,738
Agjenci zhvillimore				
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Mbështetja për hartimin/zhvillimin e planeve studimore, zhvillimore dhe studime/projekte për bashkëfinancim me donatorë, etj. (ndërvendore, rajonale, etj.) ⁽²⁾	175,000,000	175,000,000
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës/ segmenti "Rrethrotullimi i doganës - mbikalimi Kashar"	350,000,000	282,500,000
13	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i Rrugës së Elbasanit/segmenti "Fakulteti Filologjik - Unaza e Madhe"	200,000,000	147,500,000
SHUMA			1,481,363,805	1,200,000,000

1) Shënim 1

"Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).

"Vlera e financimit" për vitin 2014 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.

Diferenca e financimit të vlerës së plotë (pas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014, do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2015.

2) Shënim 2: Detajimi i fondit në projektet specifike bëhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (bordi).

VENDIM
Nr. 5, datë 9.5.2014

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E
FONDIT PËR ARSIMIN, FONDI PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3 të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, "Për buxhetin e vitit 2014", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për projekte në fushën e arsimit (arsimi bazë, i mesëm dhe profesional), në lidhje me shpërndarjen e fondeve në vlerën 680 000 000 (gjashtëqind e tetëdhjetë milionë) lekë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014. Kjo thirrje për aplikim përfshin, si më poshtë vijon:

a) projekte (pilot) për zhvillimin e arsimit të mesëm, bazë dhe profesional, si dhe të shkollës si qendër komunitare (institucionet aplikuese janë bashkitë qendër qarku);

b) projekte të rehabilitimit të shkollave në gjendje emergjente për ndërhyrje.

2. Aplikimi për fonde të thirrjes për financimin e projekteve të arsimit (bazë, të mesëm dhe profesional), sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes vendore. Aplikimet për projektet dërgohen sipas formatit të dhënë në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuara, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit përkatës teknik, në Ministrinë

e Arsimit dhe Sporteve, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të dhëna në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sporteve, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

SHTOJCA I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekt-aplikime për projekte të arsimit (bazë, të mesëm dhe profesional)
Për një periudhë 8-ditore, pas botimit në Fletoren Zyrtare	Aplikuesit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al ; 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve) 3. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
6 ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës, teknik dhe financiar.

3 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkëndimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me planet vendore, ndërvendore dhe rajonale, i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, shtojca III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkëndimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve.
2 ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati i përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të arsimit, si pjesë e FZHR-së.

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariati teknik për objektet e arsimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në pikën A të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.

SHTOJCA II: FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunitet), autoritetet dhe agjencitë zhvillimore
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/ sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (arsim)
Nënspektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënspektori i projektit (arsimi bazë, i mesëm, profesional)
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të ndërtesës ekzistuese (nëse ka) dhe terrenit, si dhe i nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve shtesë (sistem ngrohje, mur rrethues, etj.) në ndërtesat ekzistuese (nëse ka); - Cilat janë problemet që ky projekt adreson dhe shkalla e ndikimit; - Rrisqet për zbatimin e tij; - Informacion në lidhje me pronësinë e tokës (n.q.s. parashikohet ndërtimi i një objekti të ri) etj.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë (nxënës/mësues/komunitet) që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kostoja për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.

Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga Njësia e Qeverisjes Vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti: - ka vendim të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore për miratimin e projektit; - ka vendim të këshillit të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë) për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe ndërtimit të projektit; - është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëngjitet një kopje e vendimit/dokumente të tjera.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet, nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo të komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura, të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo të planit, si dhe të citohet dokumenti.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; përlllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- Online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al, si edhe

- me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik (Ministria e Arsimit dhe Sporteve).

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik (MAS) dhe listën e projekteve të aplikuar. Projektet e aplikuar duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

SHTOJCA III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Kriteret e vlerësimit teknik dhe financiar

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi maksimalisht me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik për projektet e arsimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS).

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse projekti që do të financohet, ka:

- projekt teknik, të detajuar saktë dhe qartë (hartat, gjenplane, etj.); dhe
- preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe të vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, sipas çmimeve të referencës në buletinet e përditësuara, etj.

Sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS), ngarkohet të kryejë rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, të paraqitura nga institucioni aplikues, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të përgatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 25 pikë.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike (të jepet informacion edhe në lidhje me pronësinë e tokës, në rastet e ndërtimit të objekteve të reja).

Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Niveli i ndikimit të projektit:

a) në shërbimet bazë, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillim social të zonës në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe

zhvillimit të aftësive. **Për këtë komponent, vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

b) Në nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturën arsimore, duke adresuar edhe shkakun. **Për këtë komponent, vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**

5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të nxënësve/mësuesve/banorëve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.**

6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto - përfitim etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues, etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

Pika B. Kriteret e vlerësimit të përputhshmërisë

Përdoren nga Sekretariati i Përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me **maksimalisht 30 pikë**, sipas kritereve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë /strategjitë vendore dhe/ ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonal/kombëtar. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**

2. Shkalla e ndikimit në zhvillimin social në qendrat kryesore të qarkut, ose sa projekti i investimit ndikon në konsolidimin e strukturës arsimore dhe sociale në zonën ku ndodhet projekti. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006